



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.50/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj kryesuese, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur në lidhje me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, e parashtruar kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 28.12.2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 30.12.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET E PASAFATSHME ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ZP.Anr.50/2025, e parashtruar kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 28.12.2025

A r s y e t i m

Me datë 28.12.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, në të cilën theksohet se, me 27 dhjetor 2025, në platformën Facebook është shfaqur një video nga ana e kandidatit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Sokol Havollit, në të cilën shfaqet duke bërë thirrje që të votohet, derisa ndodhet në një lokacion ku po realizohen punime infrastrukturore publike, përkatësisht në rrugë që janë në ndërtim e sipër.

Në ankesë theksohet se në video vërehen qartazi makineri të rënda ndërtimore (bagerë), të cilat janë të angazhuar në kuadër të një projekti publik të komunës përkatëse, të financuar nga buxheti publik dhe të realizuar përmes kontraktuesve të përzgjedhur nga autoriteti komunal. Aktiviteti i kandidatit zhvillohet drejtpërdrejt në këtë hapësirë, duke e shfrytëzuar vizualisht procesin e realizimit të investimit publik si sfond dhe element mbështetës të mesazhit të tij politik. Tutje në ankesë theksohet se ky aktivitet është realizuar dhe shpërndarë gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, duke synuar qartazi përfitim elektoral dhe ndikim në opinionin publik,

përmes ndërlihdjes së kandidatit me investime publike në realizim e sipër. Neni 36 i Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës ndalon shprehimisht shfrytëzimin e pasurisë publike, resurseve publike dhe aktiviteteve institucionale për qëllime të fushatës zgjedhore. Po ashtu në ankesë theksohet se në rastin konkret, kandidati ka shfrytëzuar një projekt publik aktiv rrugë në ndërtim e sipër dhe makineri ndërtimore të angazhuara nga komuna, si element qendror vizual të aktivitetit të tij të fushatës. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur ankesës në cilësinë e provës një Video incizim. Duke i propozuar PZAP që të shqiptoj masë ndëshkuese në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Në përgjigjen në ankesë, subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, ka theksuar se, ankesa e ankuesit duhet te hedhet poshtë, ngase e njëjta është ushtruar në kundërshtim me nenin 9 paragrafi 5 të Rregullores NR. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes se Ankesave. Ankesa në fjalë është bërë më 28 dhjetor 2025, ndërsa video e kandidatit për deputet nga radhët e LDK është postuar me date 22 dhjetor 2025, pra pas afatit te parapare prej 48 orësh për shkeljen e supozuar, rrjedhimisht ankesa i bie qe është bere 96 ore pas afatit apo përkthyer në dite, 4 dite të plota, Përveç faktit qe ankesa është e pasafatshme, në videon e kandidatit për deputet Shkol Havolli nuk ka kurrfarë shkelje sepse i njëjti nuk ka përdorur zyrën e tij apo pasuri publike për promovim të fushatës zgjedhore, por pune të zakonshme nga terreni.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

-Ankesa është e pasafatshme.

Paneli, pas shqyrtimit të ankesës ka gjetur se ankesa e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 39 paragrafi 3 i LZP-së, në të cilin nen në mënyrë decitive parashihet që: *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, mund të paraqes ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe PZAP-i, do të vendos për ankesën brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga koha e pranimi të saj”*, si dhe neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin nen në mënyrë decitive thuhet se *“PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim, nën paragrafi 3.2. nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor”*. Paneli, konform nenit 13 par. 7 të Rregullores Nr. 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, me të cilin parasheh *“Paneli para se të vendos lidhur me ankesën mund të kryej hetim nëse e konsideron të nevojshme dhe të arsyeshme.”* Andaj Paneli ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se e njëjta është e pasafatshme, pasi që nga shkresat e lëndës, hulumtimi dhe verifikimi në rrjetin social facebook, shihet se video e postuar nga ana e kandidatit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Sokol Havolli, ka qenë me date 22

dhjetor 2025, ndërsa parashtruesi ankesën e ka parashtruar me datë 28.12.2025, me çka vërtetohet se ankesa e ankuesit është paraqitur pas afatit ligjor prej 48 orësh.

Me dispozitën e nenit 9 paragrafi 5 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, parashihet që: “ *Personi mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara*, ndërsa nën paragrafi 5.5 parasheh që: “për shkeljet e pretenduara të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët”. Pra, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se, ankesa është parashtruar, pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesave, sipas nenit 39, paragrafi 3 i LZP-së, ku afati për dorëzimin e ankesave është 48 orë nga ndodhja e shkeljes së supozuar, ngjarja ka ndodhur me datë 22.12.2025, ndërsa ankesa është parashtruar më datë 28.12.2025, që do të thotë se njëjta është paraqitur pas afatit ligjor.

Paneli gjeti se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor, dhe duke u bazuar në nenin 118 paragraf 1 të LZP-së, dhe nenin 13 paragrafi 3 pika 3.2 të Rregullës 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
ZP.Anr.50/2025 datë 30.12.2025

Kryesuese e Panelit
Hidajete Gashi Alaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi